



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.646/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Shkelzen Bazaj kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal ne Gllogoc, nga radhët e subjektit politik AAK, me seli në Prishtinë dega në Gllogoc, për mungesë së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet pjesërisht si e bazuar ankesa e Shkelzen Bazaj kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal ne Gllogoc, nga radhët e subjektit politik AAK, me seli në Prishtinë, dega në Gllogoc.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtarë të Kuvendit Komunal në Gllogoc, nga subjekti politik AAK, në Vendvotimin: 0306/01R në Tërstenik.

III. Refuzohet si e pa bazuar ankesa e Shkelzen Bazaj kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal ne Gllogoc, nga radhët e subjektit politik AAK, sa i përket vendvotimeve në: Poglek, Gllobar, Terdec, Shtuticë, Polluzh dhe Kraikon.

A r s y e t i m

Me datën 09.11.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Shkelzen Bazaj kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal ne Gllogoc, nga radhët e subjektit politik AAK me seli në Prishtinë, dega në Gllogoc, me të cilën thekson se i mungojnë votat në vendvotimin 0306e/01R.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është pjesërisht e bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore të Shkelzen Bazaj kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal ne Gllogoc, nga radhët e subjektit politik AAK, janë pjesërisht të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për kandidatin Shkelzen Bazaj kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal ne Gllogoc, nga subjekti politik

AAK, në vendotimin me numër 0306/01R dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendotimin e lartcekur. Si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Lidhur me pjesën e refuzuar të ankesës të vendosur si në pikën III të këtij vendimi, paneli gjeti se pretendimet e ankuesit janë të pa bazuara, sepse paneli gjeti se nuk janë specifikuar vendotimet se ku janë bërë parregullsitë dhe se sa vota i mungojnë.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZL. Anr.646/2017 më datën 10.11.2017.

Kryesuesë e Panelit
Gyltene Sulajmani



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.